



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec /Municipality of Rahovec



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA
RAHOVEC / ORAJ
Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi)
Nr./Br./No 133 Nr. i faq. 45
Data/Date 18 / 9 / 23

Procesverbali për dëgjimin buxhetor me përfaqësuesit e lagjeve/bashkësive lokale, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, të rinjtë, bizneset dhe palët tjera të interesuara, për organizimin e dëgjimit buxhetor publik për buxhetin e vitit 2024, i organizuar nga anëtarët e KPF-së.

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 6 pika 1.3 UA (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti dëgjimin publik për projekt buxhetin e vitit 2024.

Dëgjimi publik filloi në orën: 14: 00

Dëgjimin e kryesoi:

- Kryesuesi i Kuvendit z. Arbër Zenuni, dhe

Nga radhët e Komitetit për Politikë dhe Financa ishte prezent vetëm:

1. Shqipe Kryeziu.

Të pranishëm në dëgjim ishin dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane të qytetit, OJQ-të dhe biznese.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim ishte: 16

Numri i femrave pjesëmarrëse ishte: 6

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në dëgjim.

Publikimet në webfaqe, platforme të konsultime publike si dhe rrjetin social facebook:

Me 4.9.2023, është publikuar njoftimin e rrjetin social facebook:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02km9aNceeJNi4egSd7ggaL15ApEzBLnteWv4U6LeV2PKFeCBDPuaYcQX8JTrJhinWl&id=100067252380999&mibextid=Nif5oz

Me 4.9.2023, është publikuar njoftimi për organizimin e dëgjimit në webfaqen zyrtare të komunës:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/09/Njoftim-publik-KPF.pdf>

Njoftimi i publikuar në platformën e konsultimeve publike:

Me 5.9.2023, është publikuar njoftimi si publikuar në webfaqe në formë të lajmi: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-me-qytetare-per-buxhetin-e-vitit-2024/>

Dëgjimi publik është mbajtur me **13.09.2023** në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe ka filluar në orën 14:00 dhe ka përfunduar në orën 14:40.

Para fillimit të dëgjimit, projekt buxheti për vitin 2024, u është shpërndarë në formë fizike të gjithë të pranishmëve gjithashtu projekt buxheti ka qenë i publikuar edhe në webfaqen zyrtare të komunës në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/09/Buxheti-i-Komunes-Se-Rahovecit-per-Vitin-2024-2026-sipas-Kategorive-Ekonomike-scan.pdf>

Hapja e dëgjimit publik është bërë nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Arbër Zenuni!

Arbër Zenuni, kryesues e Kuvendit Komunal dhe Kryesuese e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ka thënë se njoftimet për organizimin e këtij dëgjimi buxhetor janë bërë me kohë në webfaqen e komunës, në platformën e konsultimeve publike si dhe në rrjetin social facebook. Këtë dëgjim po e mbajmë pas pranimit të propozim buxhetit për vitin 2024 nga drejtori i DBF Afrim Limani. Organizimi i këtij dëgjimi është bërë nga anëtarët e KPF-së dhe Zyra për Informim, ju falënderoj për pjesëmarrje në dëgjim publik përfaqësueseve të lagjeve dhe fshatrave, OJQ-ve dhe bizneseve, kërkesat tuaja ne do ti shënojmë dhe më pastaj do t'i adresojmë tek ekzekutivi.

Prezantimin e projekt buxhetit për vitin 2024 është bërë nga Ekrem Bytyqi, Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave i cili ka thënë se buxheti për vitin 2024 është do të jetë 20.034.785.00 Euro, Paga dhe mëditje në vlerë prej 10.300.983.00 Euro, Mallra dhe Shërbime në vlerë prej 2.466.340.00 Euro, Shërbime Komunal në vlerë prej 370.000.00 Euro, Subvencione dhe

Transfere në vlera prej 890.00.00 Euro si dhe Investimet Kapitale kapin vlerën prej 6.007.462.00 Euro.

Kërkesat: Dëgjimi me qytetarë për buxhetin e vitit 2024, të organizuar nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF):

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës/sugjerimi i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1	1. Nëse mund të parashihet ndërtimi i një objekti për personat me aftësi të veçanta ashtu sikurse është ndërtuar Shtëpia për qëndrim ditor për të moshuar.	Lulzim Krasniqi-OJQ "OPFAK"-Rahovec	Aprovohet	Për vitin 2024 janë planifikuar shumat për financimin e shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara.
	2. U bënë 21 vite që komuna gjithmonë ka investuar në ndërtime, -a mundeni të bëni investime kapitale në dije, pra a llogariten investime në dije.	Shkumbin Arifi-SHL-Kosova	Aprovohet	Drejtoria e Financave, përmes projekteve që të përgatis gjatë vitit 2024, do të planifikoj që të trajtoj edhe këtë kërkesë.
	3. Lista e investimeve kapitale, si: te Shërbimet Publike dhe Zhvillimi Ekonomik nuk po specifikohen ndërsa të DBPZHR po specifikohen.	Ilir Pallqa-anëtar i Kuvendit	Aprovohet	Te buxheti-projektet që po planifikohen fjalitë janë të limituara. Projektet që na vinë në vendosim në sistem, pra përshkrimi i projekteve mund të bëhet vetëm në vijë të trasha në sistem. 89 % e kërkesave të bëra nga qytetarët janë pranuar në buxhet.
	4. Në fshatin Retijë nuk ka asnjë projekt që është parapa të bëhet. Jemi duke e shqyrtuar mundësin si kryesi e fshatit të	Mirsad Qehaja-Kryetar i fshatit Retijë	Pjesërisht	Të gjitha kërkesat dhe shqetësimet tuaja do të dorëzohet për trajtim si projekte.

	kalojmë në Komunë tjetër! Kemi probleme me rrugë fushore-nuk ka asnjë planifikim nga qeverisja komunale. Të gjitha kërkesat tjera janë të deponuara me shkrim, përveç dy kërkesave: Probleme me qentë endacak dhe plaçkitjes që nuk janë deponuar si kërkesa.			
5. Është dëgjimi buxhetor i fundit nga KPF-ja.	Ibrahim Kryeziu-Demos	Koment		
6. Sa po e shoh nuk qenka asnjë drejtor në këtë dëgjim publik?	Afrim Krasniqi	Koment		Ekzekutivi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa i kanë mbajtur 11 dëgjimet publike për buxhet nga data 14 deri më 18 gusht 2023, ndërsa ky dëgjim është planifikuar të mbahet nga Komiteti për Politikë Financa.

Vegëza në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/komiteti-per-politike-dhe-financa-mbajti-degjim-publik-me-qytetare-per-buxhetin-e-vitit/>

DËSHMI Nga DËGJIMI


 Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
 Komuna e Rahovecit
 Opština Račak / Municipality Rahovec
 

I lista e nënshkrimit të qytetarëve përkatës në degësimin bashkëkohor për punë të
 komunitetit të Rahovecit për vitin 2024 i organizuar nga Komiteti për Tërbësi dhe Shërim (KTS)

Nr	Emri	Nënkohet	Pasqja - Vendi	Nënkohet
1	Haris	Haris	Ulica e Shkupit - Vite	Haris
2	Haris	Haris	Shkup	Haris
3	Haris	Haris	Shkup	Haris
4	Haris	Haris	Shkup	Haris
5	Haris	Haris	Shkup	Haris
6	Haris	Haris	Shkup	Haris
7	Haris	Haris	Shkup	Haris
8	Haris	Haris	Shkup	Haris
9	Haris	Haris	Shkup	Haris
10	Haris	Haris	Shkup	Haris
11	Haris	Haris	Shkup	Haris
12	Haris	Haris	Shkup	Haris
13	Haris	Haris	Shkup	Haris
14	Haris	Haris	Shkup	Haris
15	Haris	Haris	Shkup	Haris
16	Haris	Haris	Shkup	Haris
17	Haris	Haris	Shkup	Haris
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				

13.9.2023

1



Dokumentin e procesverbalit e punës Qëndresa Duraku

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

